



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.282/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Violeta Husaj Rugova kryesuese, Bujar Muzaqi dhe Hajriz Hoti anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, ka paraqitur ankesë kundër Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 03.02.2025, merr këtë:

#### V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa Anr.282/2025 e datës 01.02.2025, e parashtruar nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025.

#### A r s y e t i m

Me datë 01.02.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me të cilën pretendon se aktivistë të Lëvizjes VETVENDOSJE, kanë identifikuar se në postimin e gazetarit z. Xhevdet Pozhari, është postuar një video e shkëputur nga emisioni Kallzo.Com, ku nga kandidatja për deputete nga radhët e PDK-se thuhet të pa vërteta, shpifje, fyerje dhe ndërrim i fakteve në kontekst përçmues ndaj elektoratit dhe Lëvizjes VETVENDOSJE, e cila deklaron se në kohën e qeverisjes së PDK-së, vendi është njohur nga më shumë se 200 shtete të Bashkimit Evropian, andaj ankuesit janë empatik lidhur me deklaratën e saj dhe të dhënat e deklaruara të cilat kanë për qëllim fyerjen dhe nënçmimin e qytetarëve si dhe subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje. Me tutje në ankesë pretendohet se kandidatja për deputete me deklaratën e saj ka munduar ta paraqes subjektin e saj, PDK, si parti e cila ka arritur te siguroj mbi 200 njohje nga vendet e BE, për shtetin e Kosovës. Po ashtu në

ankesë pretendohet se Bashkimi Evropian nuk përbëhet nga 200 shtete, e që është edhe fakt notar, andaj këso shpifje dhe fyerje nga manipulimi ose mosdija e kandidatës për deputete nga radhët e PDK-së , andaj konsiderojmë se ka bërë shkelje të rëndë të nenit 34 par.1 nen par 1.11, duke mashtruar dhe devijuar të vërtetën si dhe duke bërë fyerje ndaj subjektit politik Lëvizja Vetvendosje.

Si dëshmi për pretendimet e tij, paraqitësi i ankesës, ka bashkangjitur një CD dhe Link video facebook .

Më datë 01.02.2025, PZAP-i, e njoftoi Subjektin Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), për ankesën e paraqitur kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur me datë 02.02.2025, Subjektin Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), thekson se përmes kësaj përgjigje ne ankesë kërkon nga PZAP-i, që ta refuzoj si të pa bazuar, ku pretendon se ankesa është dorëzuar pas afatit të përcaktuar në nenin 119, par 1 te Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme ne Republikën e Kosovës, ku pretendohet se emisionit të cilit i referohet ankuesi është publikuar më datë 28 janar 2025 nga Kallzo.Com dhe se ankesa është parashtruar më datë 01 shkurt që nënkupton 3 ditë pas shkeljes së pretenduar. Me tutje në përgjigje në ankesë theksojnë se deklarata e z.nj. Blerta Deliu nuk përmban asnjë përdorim të gjuhës nxitëse, fyerje apo shpifëse, siç pretendojnë ankuesit e subjekti politik LVV, dhe fakti se deklarimi i saj përbën ose jo shpifje nuk mundë të trajtohet nga PZAP-i, pasi qe e njëjta nuk ka juridiksion për të shqyrtuar ekzistimin e shpifjes dhe se një procedurë e tillë do të duhej të zhvillohet dhe të vërtetohej në gjykatën kompetente civile dhe jo nga PZAP-i .Andaj sipas rrethanave të rastit konkret PDK-ja përmes këtyre veprimeve nuk është përgjegjëse për shkeljet të rregullave të përcaktuara në Rregulloren Zgjedhore nr. 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës se Zgjedhjeve dhe Reklamimin Financiar si dhe Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme.

Në përgjigje në ankesë subjekti politik PDK, si provë ka bashkangjitur screenshot nga video e publikuar në Kallxo.Com, e cila është transmetuar në kohë reale dhe e cila është shpërndarë më datë 28 Janar 2025

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 3 të LZP-së, konstatoi se:

### **Ankesa është e pabazuar**

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga Subjekti Politik PDK, vlerësoj se pretendimet e Subjektit Politik LVV, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të dispozitës së nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11 të LZP-së, me të cilën përcaktohet: *“Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: ... 1.11) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë”.*

Kjo për faktin se parashtruesi i ankesës i referohet shkeljes së dispozitës ligjore të lartcekur, mirëpo paneli pas shikimit të bërë artikullit të ofruar si provë materiale CD, e cila është publikuar në rrjetin social Facebook, paneli vërtetoi se janë të pa qëndrueshme pasi që deklarimi i bërë nga kandidatja në fjalë lidhur me promovimin e punës dhe programit të subjektit të tyre, gjatë fushatës zgjedhore, nuk ka përdorur gjuhë denigruese dhe nxitëse që mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve, në këtë rast ndaj subjektit politik LVV,. Me qenë se nga provat e ogruara nuk ka mund të përcaktohet shkelje e përcaktuar me dispozitën e nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11 të LZP-së, prandaj edhe pretendimet ankimore si të tilla i refuzoj.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: “vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë nga parashtruesi i ankesës nuk paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, dhe të njëjtën e refuzoi si të pabazuar.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Anr.282/2025 më datë 03.02.2025

Kryesuese i Panelit  
Violeta Husaj Rugova



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.